



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1141/2 prot.

Vlorë, më 02.10.2018

VENDIM

Nr. 63, datë 1.10.2018

PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR HARTIMIN E RREGULLORES SË ZGJEDHJEVE PËR KËSHILLAT STUDENTORË NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË

Mbështetur në nenin 38 dhe nenin 99 të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 1.10.2018

VENDOSI:

1. Të miratojë ngritjen e grupit të punës për hartimin e rregullores së zgjedhjeve për këshillat studentorë në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë me përbërje si më poshtë:
 - a) Zv/rektori akademik;
 - b) 1 (një) përfaqësues i Zyrës Juridike;
 - c) 1 (një) përfaqësues i Sektorit të Këshillimit të Studentëve, Alumni dhe Aktiviteteve Studentore;
 - d) 1 (një) anëtar i Komisionit Institucional Zgjedhor të UV-së.
 - e) 1 (një) përfaqësues student nga Senatit Akademik;
 - f) 2 (dy) përfaqësues studentë nga Fakulteti i Ekonomisë.
 - g) 2 (dy) përfaqësues studentë nga Fakulteti i Shkencave Teknike.
 - h) 2 (dy) përfaqësues studentë nga Fakulteti i Shkencave Humane.
 - i) 2 (dy) përfaqësues studentë nga Fakulteti i Shëndetit Publik.
2. Përcaktimet dhe kriteret për procesin e aplikimit të studentëve në cilësinë e përfaqësuesve sipas pikës 1, gërmat f, g, h, i janë:
 - a) Kanë të drejtë të vetëkandidohen studentë që ndjekin studimet në:
 - Bachelor, viti II dhe III
 - Master në përfundim të vitit të I



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- b) Kanë notën mesatare aritmetike ≥ 7 . Nota mesatare e secilit aplikant do të verifikohet nga sekretaria mësimore përkatëse.
3. Afatet e aplikimit pranë dekanatave përkatëse të jenë 2018.
 4. Dekanët e fakulteteve dhe Këshilli Studentor i UV-së të marrin masa për njoftimin në kohë të studentëve.
 5. Grupi i punës do të ngrihet më pas me urdhër të Rektorit.
 6. Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI

